21Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arteve të Aplikuara**
Titulli i lëndës:	**Fotografi I**
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**1**
Numri i orëve në javë:	**3**
Vlera në kredi – ECTS:	**5**
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë trajton në mënyrë sistematike zhvillimin historik dhe teorik të fotografisë, duke filluar nga shpikja e saj dhe evolucionin në periudha të ndryshme të historisë, deri në praktikat bashkëkohore digjitale. Në kuadër të saj, analizohet transformimi i proceseve fotografike nga teknikat manuale dhe analoge drejt digjitalizimit, duke theksuar ndikimin e zhvillimeve teknologjike në formësimin e gjuhës vizuale fotografike. Lënda përfshin gjithashtu studimin e pajisjeve fotografike ndër vite, duke filluar nga kamera obscura, aparatet me film, deri te sistemet moderne digjitale. Përmes integrimit të komponentit teorik dhe praktik, synohet zhvillimi i aftësive analitike dhe profesionale të studentëve në përdorimin e aparatit fotografik, si dhe në kuptimin dhe aplikimin e proceseve themelore dhe të avancuara të fotografisë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është përvetësimi i njohurive të thelluara mbi zhvillimin historik dhe teknologjik të fotografisë, nga origjina e saj deri në epokën digjitale, si dhe zhvillimi i kompetencave profesionale të studentëve në përdorimin dhe aplikimin e teknikave fotografike në kontekste të ndryshme vizuale dhe kreative.
Rezultatet e pritura të nxënies:	**Rezultatet e pritura të nxënies:** Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje të: • aplikojë në mënyrë të pavarur dhe profesionale përdorimin e aparatit fotografik; • identifikojë dhe shpjegojë pjesët themelore dhe funksionimin e kamerave fotografike; • vlerësojë karakteristikat teknike dhe estetike të aparateve dhe imazheve fotografike; • analizojë në mënyrë kritike aparatet dhe fotografitë, me theks të veçantë në kontekstin e fotografisë digjitale.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithësej**
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2	4
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1	2
Projektet, prezentimet, etj	2	15	30
Totali			**126**

Metodologjia e mësimëdhënies:	*Ligjerata dhe ushtrime të kombinuara me raste te studimit dhe diskutime në klasë*
Metodat e vlerësimit:	30% Punime Praktike 10% Prezantim 60% Provim final
Literatura	
Literatura bazë:	MARK OSTERMAN, GRANT B. ROMER, HISTORY AND EVOLUTION OF PHOTOGRAPHY.
Literatura shtesë:	Rick Doble, Brief History of Light & Photography Newhall Beaumont, The History of Photography

Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	**Ligjerata që do të zhvillohet**
Java e parë:	***Historia e fotografisë – hyrje***
Java e dytë:	***Kamera obskur***
***Java e tretë*:**	***Pllakat emolusioni ne fotografi***
Java e katërt:	***Dagerotipet***
Java e pestë:	***Kodak***
***Java e gjashtë*:**	***Pjeset themelore te kamerave***
Java e shtatë:	***Kamera digjitale***
Java e tetë:	***Përsëritje***

Java e nëntë:	***Hapat e pare te fotografise***
Java e dhjetë:	***Fotografia në natyrë***
***Java e njëmbedhjetë*:**	***Si te fotografojme nje portret***
***Java e dymbëdhjetë*:**	***Rendesia e drites natyrale***
***Java e trembëdhjetë*:**	***Perdorimi i blicave shtese***
***Java e katërmbëdhjetë*:**	***Fotografia bardh e zi***
***Java e pesëmbëdhjetë*:**	***Rendesia e ngjyrave ne fotografi***
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.	